

Udhëzues për publikime shkencore

Identifikimi dhe shmangia e revistave dhe botuesve të dyshimtë

Hyrje

Udhëzuesi për identifikimin dhe shmangien e revistave dhe botuesve të dyshimtë, është hartuar me qëllim që të orientojë stafin akademik dhe shkencor të identifikojnë dhe shmangin publikimet në revista e botues të dyshimtë, duke promovuar një kulturë të cilësisë dhe integritetit shkencor.

Në shoqërinë e sotme të [platformave](#), numri i revistave dhe botuesve me praktika të pandershme, ka shënuar ngritje të hovshme. Kjo paraqet sfida për stafin akademik dhe shkencor si dhe rrezikon kredibilitetin e punimeve shkencore dhe të vetë institucioneve të arsimit të lartë.

Objektivat kryesorë të këtij udhëzuesi janë:

- Të ndihmojë stafin akademik në njohjen dhe identifikimin e praktikave të dyshimta të publikimeve shkencore (*predatory, hijacking, vanity*);
- Të sigurojë një kornizë të qartë për shmangien e publikimeve të dyshimta në përputhje me rregulloret kombëtare dhe praktikat ndërkombëtare;
- Të shërbejë si një udhëzues për përzgjedhjen e revistave dhe botuesve cilësorë, duke kontribuar në zhvillimin e shkencës së mirëfilltë dhe në ruajtjen e integritetit shkencor.

Ky dokument është hartuar në përputhje me normat pozitive të Kosovës¹ dhe të praktikave të universiteteve europiane që kanë të bëjnë me identifikimin dhe shmangien e revistave dhe botuesve të dyshimtë.

Ç'janë revistat dhe botuesit e dyshimtë?

Revistat dhe botuesit e dyshimtë (të njohura si "predatory journals" dhe "predatory publishers") janë entitete që pretendojnë të jenë platforma shkencore, por në të vërtetë ndjekin praktika të pandershme për përfitime financiare. Ato shpesh dëmtojnë integritetin akademik duke publikuar punime pa kryer recensione (peer review) cilësore dhe pa respektuar standardet e pranuar ndërkombëtare për botimet shkencore. Deri më tani, disa [qindra mijëra studiues kanë rënë pre](#) e këtyre botuesve apo kanë publikuar

¹ - <https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/Draft-version-of-the-KAA-Accreditation-Manual-2024.pdf>

- <https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/10/1.-Standards-for-Evaluation-of-PhD-Standards.pdf>

në revista pseudo-shkencore, përfshirë ata [nga vendet e BE-së](#), ndërsa sipas një studimi të publikuar nga MIT, viktimat më të mëdha në kontinentin europian në një kohë, kanë qenë [shqiptarët](#).

[Beall](#) ishte ndër të parët që identifikoi dhe kategorizoi revistat dhe botuesit e dyshimtë. Ai përcaktoi botuesit predatory si ata që shfrytëzojnë modelin e botimit me qasje të hapur duke i ngarkuar autorët me tarifa botimi (APC) pa ofruar shërbime cilësore të vlerësimit të punimeve shkencore. [Committee on Publication Ethics \(COPE\)](#) i përkufizon këto si praktika të pandershme në publikimet shkencore dhe se revistat e dyshimta (grabitqare) nuk i plotësojnë standardet minimale për cilësi dhe etikë.

Qëllimi kryesor i [revistave të dyshimta](#) është profiti. [Ato](#) mundësojnë publikimin e një punimi brenda një periudhe të shkurtër, në këmbim të një [pagese \(APC\)](#) në revistat me qasje të hapur (open access).

Shumë nga revistat e dyshimta u dërgojnë [email autorëve](#) duke i ftuar ata që të dergojnë artikuj për të publikuar në revistat e tyre, ndërsa disa prej tyre janë të klonuara apo duplikat. [Ato](#) imitojnë revista të tjera serioze ndërsa, duke vendosur emrin e njëjtë të revistës me një revistë serioze, ndërkaq janë thjesht për të rrëmbyer paratë e autorëve ([hijacked journals](#)).

Por, problemi më i vështirë është me revistat të cilat për një periudhë respektojnë kriteret shkencore, indeksohen në Scopus apo Web of Science (WoS), botojnë disa numra sa për të fituar besimin dhe më pas komercializohen. Këto revista [rrisin ndjeshëm numri i punimeve](#) të publikuara në krahasim me një vit më parë, madje edhe i shumëfishojnë ato, duke ulur cilësinë për të shtuar fitimin. Revista të tilla që bëhen grabitqare duke qenë të indeksuara, zakonisht hyjnë në [rivlerësim nga Scopus](#) dhe largohen bashkë me abstraktet e indeksuara në vitin 'komercializues'. Njëjtë ndodh edhe me revistat e indeksuara në WoS. "WoS i rivlerëson periodikisht revistat për të siguruar që përmbajtja të vazhdojë të përmbushë kriteret tona të përzgjedhjes. Çdo revistë që nuk plotëson më kriteret tona të cilësisë, [hiqet nga mbulimi në WoS](#)". Web of Science vetëm në vitin 2023 futi në program rivlerësimi mbi [500 revista](#) që dyshonte për cilësinë e publikimeve, duke përjashtuar disa dhjetëra prej tyre.

Megjithatë, vlen të theksohet se një kërkues i kujdesshëm shkencor mund të identifikojë shumë lëshime në disa revista të cilat kanë filluar të komercializohen dhe të bëjnë kompromise me cilësinë ndërsa ende qëndrojnë në Scopus/WoS sepse programi i rivlerësimit ende mund të mos i ketë përfshirë ato revista. Prandaj rekomandohet që nëse revista nuk është shumë e njohur dhe e dëshmuar për cilësi ndërsa është e indeksuar në platformat kryesore (Scopus dhe WoS), autori, para se ta dërgojë punimin e tij/saj, të shfletojë artikujt tashmë të publikuar nga ajo revistë.

Karakteristikat e revistave dhe botuesve të dyshimtë

- Revistat që kërkojnë pagesa të mëdha, shpesh pa e justifikuar koston me cilësinë e shërbimeve të ofruara, duhet të ngjallin dyshime;
- Revista që nuk ka një fokusim të qartë në fusha studimi dhe pranon artikuj nga çdo fushë shkencore, shpesh i mungon rigoroziteti akademik dhe duhet t'ju nxisë dyshime;
- Revistat e dyshimta në mënyrë shumë agresive shpallin thirrje për publikime. Ftesat për publikime mund t'ju vijnë nga adresa individuale apo botues dhe shpesh ju gjinden ne spam. Revistat legjitime nuk i thërrasin autorët. Përkundrazi, autori i kërkon revistat;
- Instruksionet janë të mangëta për autorët;
- Recensenti (peer reviewer) është tejmase i shpejtë në punën e tij (disa ditë). Dyshoni se ai mund edhe të mos ekzistojë fare;
- Artikujt kërkohej të dorëzohen përmes email-it ([disa grabitqarë](#) përdorin edhe sistem online të menaxhimit editorial legjitim – por kjo nuk i bën ato legjitimë);
- Pranimi i menjëhershëm për t'u botuar (accepted) ose shumë i shpejtë i dorëshkrimeve tregon mungesë të një recensionit të kujdesshëm;
- Nëse nuk ka një adresë të verifikueshme ose vendndodhja nuk lidhet logjikisht me natyrën e revistës, kjo është një shenjë paralajmëruese;
- Revista që përmend një numër të madh redaktorësh të cilët nuk janë ekspertë të njohur në fushën e tyre, rrezikon të jetë e dyshimtë;
- Përdorimi i një gjuhe të pasaktë ose joprofesionale në korrespondencë është tregues i mungesës së seriozitetit;
- Kontaktimi i autorëve pa asnjë lidhje paraprake, shpesh përmes e-mail-eve të përgjithshëm, është një praktikë e zakonshme e revistave të dyshimta;
- Revista që ka dyfishuar apo shumëfishuar numrin e artujve (edhe të indeksuara në Scopus), futet zakonisht në program rivlerësimi nëse është komercializuar;
- Revista që publikon më shumë se katër numra në vit shpesh tenton të maksimizojë fitimet duke kompromentuar cilësinë;
- Revistat që ofrojnë shërbime redaktimi e përmirësimi të punimit janë revista padyshim grabitqare;
- Përdorimi i adresave të email-it privat, në vend të atyre institucionale, është një tjetër element që ul besueshmërinë dhe shton direkt dyshimin;

- Kur themeluesi i një shtëpie botuese është gjithashtu redaktor i shumicës së revistave të saj, kjo mund të jetë një shenjë manipulimi;
- Proceset e paqarta të recensionit dhe publikimit shpesh fshihen për të mbuluar mungesën e transparencës;
- Një platformë online e dobët dhe deklarata të tepruara për reputacion janë tregues të një reviste të dyshimtë;
- Gabime daktilografike, gjuhësore, bibliografike dhe web joprofesional, janë dëshmi të sigurta për revistat e dyshimta;
- Fshehja e informacionit mbi rregullat e botimit ose praktikat financiare (APC);
- Disa nga këto revista falsifikojnë legjitimitetin e impakt faktorit. Revistat që deklarojnë faktori impakti (si GIF, UIF, CiteFactor etj.), janë padyshim revista të dyshimta dhe të paindeksuara në Scops dhe WoS. Vetëm JCR/JCI (e WoS) dhe Cite Score (e Scopus) ofrojnë faktor impakti;
- Frekuenca e publikimit është jo e rregullt dhe nuk theksohet koha e publikimit;
- Vështirë të komunikosh me redaktorin/redaktorët përmes emailit, e aq më pak përmes telefonit.

Udhëzime për stafin akademik

Para se të dërgoni një artikull në ndonjë revistë, kontrolloni paraprakisht:

- Nëse revista është në [Scopus](#) apo në [WoS](#) (SCIE, SSCI and AHCI, por jo edhe ESCI);
- Të mos e ketë dyfishuar/shumëfishuar numrin e abstrakteve të indeksuara në Scopus në vitin e fundit;
- Shikoni sa sa numra ka revista (tregoni kujdes më të shtuar nese ka mbi 4 numra në vit);
- Dyshoni gjithashtu nëse në një numër ka publikuar disa dhjetëra artikuj, shmangiuni nëse ka qindra artikuj në një numër;
- Shmangiuni emailave që ju bëjnë ftesë për të botuar në revistat e tyre me joshjen se do t'ju bëjnë anëtar bordi të revistës;
- Shmangiuni ofertave me email me çmime të ulëta dhe të larta me qasje të hapur dhe publikim të shpejtë.

Nëse megjithatë keni rënë viktimë nga një proces botimi te ndonjë revistë e tillë, atëherë mund të veproni si më poshtë:

- [Tërhiqeni](#) punimin nga revista të tilla.

Nëse keni nënshkruar bartjen e së drejtës së autorit apo keni aprovuar punimin për atë revistë, shanset për ta tërhequr punimin nga revista janë mjaft të vogla. Nënvizojmë se është shumë me rëndësi që të shmangim botimin në këto revista që nga fillimi.

Nëse punimi tashmë është botuar ndërsa revista rezulton i larguar nga Scopus/WoS, kontaktoni botuesin (përmes emailit, telefonit) dhe kërkoni që artikulli të tërhiqet nga web faqja. Në shumicën e rasteve, autorët nuk do të marrin përgjigje nga botuesi, madje edhe pas përpjekjeve të përsëritura. Por, nëse e tërheqin, ju mund ta botoni atë punim në një revistë të rregullt.

Burimet për identifikimin e revistave të dyshimta

Identifikimi i revistave predatory ndonjëherë mund të jetë një punë e vështirë sepse mund të rastisë që ju te jeni i/e pafat nëse qëlloni ta dërgoni punimin tuaj në një fazë kur revista sapo ka nisur të 'komercializohet', shumëfishojë numrin e artikujve ndonëse ka rezultuar në rregull në Scopus apo WoS. Siguria rritet kur ju përcaktoheni për shtëpi botuese universitetesh në vend të shoqatave apo asociacioneve jo të njohura të cilët janë botues.

Disa universitete europiane dhe amerikane sugjerojnë që për të identifikuar dhe shmangur revistat dhe botuesit e dyshimtë, të konsultohen paraprakisht bazat e mëposhtme²:

- *Lista e Beall për revistat dhe botuesit grabitqarë: [Lista e Beall](#)*

• Kjo listë është një nga burimet më të përdorura për të identifikuar botuesit dhe revistat grabitqare. Lista kategorizon botuesit sipas praktikave si pretendime mashtruese, tarifa të tepërta dhe mungesë të një recensionit të duhur shkencor. Por, kjo listë është mbyllur në vitin 2017 [pas presioneve](#) që i janë ushtruar Beall nga publikues të fuqishëm grabitqarë. Në listën e tij sot të tjerë kanë bërë aty disa përditësime.

- *Kriteret e Cabell për revistat e dyshimta: [Kriteret e Cabell](#)*

• Cabell ofron një set të detajuar kriteresh për të vlerësuar revista të mundshme grabitqare. Ajo përfshin flamuj të kuq si bordet editoriale të paqarta, procese të paqarta të recensionit shkencor dhe tarifa të larta për pagesë.

- *Baza e të dhënave për revistat dhe botuesit grabitqarë: [Revistat Predatory](#)*

• Kjo listë ka kooptuar listën e Beall dhe është e përditësuar vazhdimisht, duke ofruar edhe artikuj të ndryshëm informues për veprimet që ndërmerren Scopus dhe WoS ndaj revistave e botuesve të dyshimtë.

² <https://isu.libguides.com/publishingyourscholarlyarticle/predatoryjournals#s-lq-box-23778035>
<https://library.maastrichtuniversity.nl/research/sharing-output/open-access-guide/predatory-and-questionable-publishing-practices/>
<https://library.isti.cnr.it/index.php/en/risorse-en/predatory-publishers>
<https://www.utwente.nl/en/bms/news/2023/7/1040499/questionable-publishing>
<https://ethicsblog.crb.uu.se/2022/08/23/where-to-publish-and-where-not-to-publish-in-bioethics-the-2022-list/>
<https://www.eur.nl/en/library/research-support/open-access/predatory-journals>

Të shmangen edhe konferencat grabitqare

Përveç revistave dhe publikuesve të dyshimtë, [Rregullorja për grante](#) e Kolegjit AAB kërkon të shmangen edhe konferencat grabitqare. Ajo sugjeron që stafi të ndjekë konferenca të cilat organizohen nga institucione arsimore dhe akademike europiane.

Pjesëmarrësit udhëzohen që paraprakisht të jenë të vëmendshëm nëse:

- Konferenca organizohet nga një entitet profitabil apo nga një entitet apo shoqëri akademike;
- Nëse konferenca është e fokusuar, apo kombinon fusha apo disiplina të shumta brenda një konference;
- Nëse konferencat përdorin email adresa jointucionale si p.sh.@gmail etj;
- Organizatorët kërkojnë (si/me spam) që pjesëmarrësit të paraqesin propozimet e tyre. Shpesh këto emaila (spam) përmbajnë gjuhë hiporbolike se konferenca qenka shumë prestigjioze, ndërsa kanë bashkuar fusha të pabashkuara;
- Informacionet për organizatorin e konferencës janë të paqarta, joekzistente ku organizatori nuk është i njohur apo s'ka reputacion akademik e shkencor;
- Pranimi për pjesëmarrje premtohet të jetë i shpejtë (shpesh më shpejt se brenda një jave);
- Konferenca është më shumë si një lloj pushimi në një destinacion të dëshiruar. Ngjarja mbahet në një hotel a resort apo në një vend turistik të shenjuar si pushim në vend se si ngjarje akademike apo shkencore;
- Konferenca ka një ngjashmëri të habitshme me konferenca të mëdha e të njohura duke vënë vetëm disa dallime minore;
- Organizatorët garantojnë se kontributet do të botohen si një punim në një revistë që shoqërohet me konferencën, ndërsa më vonë organizatorët mund t'ju ngarkojnë me pagesa shtesë për botimin e punimit tuaj.
- Web faqet e konferencave nuk janë stabile. Ato mund t'i ndryshojnë URL apo ato nuk kanë dëshmi për konferencat e viteve të kaluara;
- Web faqet kanë një gjuhë të varfër dhe kanë gabime të shumëta në të shkruar.
- Çmimet e konferencës janë shumë të larta krahasuar me ato që organizohen nga shoqëritë akademike.

Shënim:

Plotësimet dhe ndryshimet e mundshme të këtij udhëzimi do të bëhen në bazë të vlerësimeve periodike, duke u bazuar në zhvillimet dhe në dinamikat në fushën e publikimeve shkencore, sidomos lidhur me listat dhe platformat për revista të dyshimta. Plotësimet dhe ndryshimet e mundshme të këtij udhëzimi do të bëhen edhe për t'u harmonizuar me kërkesat që do të dalin nga rregullativa e re ligjore në Kosovë.

Udhëzuesi është miratuar me votë unanime, në mbledhjen e Këshillit Shkencor, të mbajtur me datë 23.01.2024, sipas të drejtave dhe detyrimeve që ka ky këshill nga [Rregullorja e punës](#).

Këshilli Shkencor i Kolegjit AAB

Prishtinë, janar 2025